



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 4062/Prot.

Tiranë më 26.11.2021

VENDIM

Nr. 51, datë 25.11.2021

“Për reduktimin e tarifës së shkollimit për 8 (tetë) studentë, punonjës të Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish Sigurimit të Shtetit, në programin e studimit të ciklit të dytë “Drejtësi Tranzitore”, në FSHS të UT-së”

Bazuar në ligjin nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në RSH”, neni 3, pika 3, germa “ç”; neni 38, pikat 1 dhe 3; neni 98, pika 2, germa “c”; VKM nr. 288, datë 21.05.2018 “Për miratimin e kufirit maksimal të tarifës vjetore të shkollimit për studentët që ndjekin studimet në institucionet publike të arsimit të lartë, në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale me kohë të plotë”, i ndryshuar; Statutin e UT-së, neni 7, pika 3, germa “ç”, neni 31, germa “u”, si dhe në kërkesën nr. 1823 prot., datë 19.11.2021 të Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish Sigurimit të Shtetit, në mbledhjen e datës 25.11.2021, Senati Akademik i Universitetit të Tiranës,

VENDOSI:

1. Reduktimin në masën 30% të tarifës së shkollimit në programin e dytë të studimit, për 8 (tetë) studentë, punonjës të Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish Sigurimit të Shtetit, në programin e studimit të ciklit të dytë, “Drejtësi Tranzitore”, në FSHS të UT-së.
2. Vendimi t’i përcillet Bordit të Administrimit të Universitetit të Tiranës.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Prof. Dr. Artan Hoxha